



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 22.01.2024, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin dhjetor 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.
3. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri - Kosovë.
4. Mbi shqyrtimin e kërkesës për shtyrje të afatit të derogimit të shoqërisë Kalisi Hydropower sh.p.k..
5. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
6. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 161, datë 17.06.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Vokopola 1”, me kapacitet të instaluar 274 kW, “Vokopola 2”, me kapacitet të instaluar 3104 kW dhe “Vokopola 3”, me kapacitet të instaluar 2297 kW, me kapacitet total të instaluar 5675 kW”, i ndryshuar.
7. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 299, datë 19.10.2023, për dhënien e autorizimit nga ERE shoqërisë “TRUEN” sh.p.k. për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.